



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE

OLIMPIADA KOMBËTARE E HISTORISË
NË ARSIMIN E MESËM TË LARTË

Faza e dytë

Klasa 12

31 janar 2026

Udhëzime për nxënësin:

- Olimpiada fillon në orën 10:00 dhe mbaron në orën 13:00.
- Testi përmban 5 pyetje.
- Për secilën pyetje është lënë hapësira e nevojshme për të shkruar përgjigjen.

Për përdorim nga komisioni i vlerësimit

Pyetja	1	2	3	4	5
	10 pikë	10 pikë	10 pikë	10 pikë	10 pikë
Pikët e fituara					

Totali i pikëve të fituara

KOMISIONI I VLERËSIMIT

1.....

2.....

1. Aleksandri i Madh dhe Genghis Khan krijuan perandori të mëdha në vende dhe kohë të ndryshme. Aleksandri përhapte kulturën greke dhe themelonte qytete, ndërsa Genghis Khan organizoi administratë dhe ligje për kontrollin e perandorisë. Të dy lanë trashëgimi të madhe: Aleksandri në kulturë dhe qytetërim, Genghis Khan në politikë dhe rend ushtarak.



Aleksandri i Madh mbreti i Maqedonisë
në shekullin IV p.e.s



Genghis Khan themeluesi i Perandorisë Mongole
në shekullin XII–XIII

- a) Analizë situative - Imagjinoni që Aleksandri i Madh do të kishte jetuar në kohën e Genghis Khanit. Bazuar mbi stilin e tij të pushtimit dhe menaxhimit të territoreve, me cilat sfida të reja do të përballej dhe si do t'i adresonte ato? **2 pikë**

Përgjigje e saktë:

Aleksandri i Madh do të përballej me terrene më të vështira stepash dhe klimë më ekstreme, sfida për lëvizjen e ushtrisë dhe bashkimin e fiseve nomade. Ai do të përdorte strategji të shpejta dhe themelim qytetesh, duke krijuar baza të forta dhe duke vendosur administratë lokale për të menaxhuar popullsinë e pushtuar, në stilin e tij helenistik.

- b) Argumentim - Genghis Khan krijoi një administratë efektive për një perandori shumëfishe, ndërsa Aleksandri përhapte kulturën helenistike përmes qyteteve që themelonte. Cila qasje do të kishte pasur ndikim më të qëndrueshëm në një perandori të sotme dhe pse? **2 pikë**

Përgjigje e saktë:

Qasja e Genghis Khanit do të kishte pasur ndikim më të qëndrueshëm, sepse krijoi strukturë administrative dhe ligjore për menaxhimin e një territori shumë të madh, gjë që lejon bashkërendim dhe stabilitet afatgjatë. Qasja e Aleksandrit të Madh, përhapja e kulturës dhe themelimi i qyteteve, ishte më e fuqishme për ndikim kulturor, por më pak e qëndrueshme pa një administratë të fortë.

- c) Analizë krahasuese e ndikimit - Përshkruani tre aspekte ku Aleksandri dhe Genghis Khan ndryshonin më shumë: strategjia ushtarake, ndikimi kulturor dhe strukturat administrative. Jepni shembuj konkretë. **2 pikë**

Përgjigje e saktë:

Strategjia ushtarake:

- Aleksandri përdorte fushata të shpejta dhe formacione të avancuara.
- Genghis Khan përdorte mobilitet të madh, harkun dhe kuajt e shpejtë.

Ndikimi kulturor:

- Aleksandri përhapte kulturën helenistike dhe themelonte qytete.
- Genghis Khan ndikoi kryesisht në strukturën shoqërore dhe ligjin.

Strukturat administrative

- Aleksandri vendoste administratë lokale në qytete.
- Genghis Khan krijoi një sistem të centralizuar dhe hierarkik për të mbajtur një perandori shumëfishe.

- d) Pyetje hipotetike - Çfarë do të ndodhte në historinë e Evropës nëse Genghis Khan do të kishte përdorur të njëjtën metodë të përhapjes së kulturës si Aleksandri? **2 pikë**

Përgjigje e saktë:

Nëse Genghis Khan do të përhapte kulturën helenistike, ai mund të kishte krijuar një influencë më të madhe kulturore mbi Evropën Lindore dhe Azinë Qendrore, duke kombinuar pushtetin ushtarak me arsimin, artin dhe shkencën. Kjo mund të kishte ndikuar në zhvillimin më të hershëm të qytetërimeve urbane dhe shkencore në hapësirat e kontrolluara nga mongolët.

- e) Analizë e trashëgimisë - Cila figurë historike la një trashëgimi më të dukshme në aspektin kulturor dhe cila në aspektin politik/administrativ? Argumentoni me shembuj të qartë. **2 pikë**

Përgjigje e saktë:

Trashëgimia kulturore: Aleksandri i Madh, për shkak të përhapjes së kulturës helenistike, artit dhe themelimit të qyteteve (p.sh., Aleksandria në Egjipt).

Trashëgimia politike/administrative: Genghis Khan, për shkak të krijimit të një administrate dhe ligjesh që lejuan funksionimin e perandorisë mongole dhe ndikuan mbi organizimin e shteteve më vonë.

2. Burimet historike tregojnë aktivitetin e perandorit bizantin Justinian I (527–565) dhe veprën e tij të famshme, Kodi i Justinianit, i cili kodifikoi ligjet romake dhe përcaktoi mënyrën e funksionimit të shtetit dhe shoqërisë. Në Shqipëri, Kanuni i Lekë Dukagjinit (shek. XV-XVI) ka pasur një ndikim të ngjashëm mbi jetën shoqërore dhe ligjore në zonat shqiptare.

Krahasoni ndikimin e Kodit të Justinianit me Kanunin e Lekë Dukagjinit në strukturat ligjore, shoqërore dhe kulturore, duke u bazuar në pikat e mëposhtme:

- a) Burimi dhe natyra e ligjit **2 pikë**
Pyetje: Cili ishte burimi i këtyre 2 ligjeve dhe si ndikonte secili prej tyre në jetën e përditshme të njerëzve?

Përgjigje e saktë:

Kodi i Justinianit ishte ligj i shkruar, i bërë nga shteti dhe administrata perandorake dhe zbatimi i tij ishte i detyrueshëm për të gjithë qytetarët; ai rregullonte marrëdhëniet civile, të drejtat dhe detyrimet ndaj shtetit.

Kanuni i Lekë Dukagjinit ishte ligj tradicional i bazuar mbi zakonet dhe traditën, kryesisht i transmetuar gojarisht, i zbatuar nga kryepleqtë dhe fiset; ai mbulonte marrëdhëniet brenda dhe ndër-familjare dhe siguronte rendin shoqëror në komunitet.

- b) Fusha e mbulimit të ligjit **2 pikë**
Pyetje: Cilat fusha të jetës mbulonte secili ligj?

Përgjigje e saktë:

Kodi i Justinianit mbulonte ligjin civil, penal, administrativ dhe të kishës, duke pasur ndikim të gjerë mbi gjithë shoqërinë.

Kanuni i Lekë Dukagjinit përqendrohej në jetën shoqërore, trashëgiminë, martesat, të drejtat e pronës dhe drejtësinë midis fisit, duke mos pasur ndikim mbi institucionet shtetërore të mëdha.

- c) Roli i shtetit dhe autoritetit **2 pikë**
Pyetje: Si ndryshonte roli i autoritetit shtetëror në zbatimin e ligjit?

Përgjigje e saktë:

Kodi i Justinianit shërbente si instrument i fuqisë shtetërore, ku gjykatat dhe administrata e perandorisë siguronin zbatimin.

Kanuni i Lekë Dukagjinit ishte instrument i vetë-rregullimit lokal, i mbajtur nga fiset dhe pleqtë e komunitetit; nuk kishte një shtet central që e zbatonte, por funksiononte mbi bazën e respektit dhe autoritetit të lokalëve.

- d) Ndikimi mbi strukturën sociale dhe ekonominë **2 pikë**
Pyetje: Si ndikuan këto ligje në marrëdhëniet shoqërore dhe ekonomike?

Përgjigje e saktë:

Kodi i Justinianit konsolidonte hierarkinë sociale dhe fuqizonte shtetin, duke vendosur rregulla për pronën dhe detyrimet e qytetarëve ndaj autoritetit.

Kanuni i Lekë Dukagjinit ruante strukturën fisnore dhe marrëdhëniet ndërkomunitare, ndikonte mbi mënyrën e përdorimit të tokës dhe ndarjes së pasurisë dhe krijonte sistemin e përgjegjësisë dhe dënimeve në komunitet.

- e) Përjetësia dhe ndikimi historik **2 pikë**
Pyetje: Cili ishte ndikimi afatgjatë i këtyre ligjeve?

Përgjigje e saktë:

Kodi i Justinianit ndikoi mbi ligjësinë evropiane dhe më gjerë, duke qenë bazë e jurisprudencës për shekuj.

Kanuni i Lekë Dukagjinit ndikoi mbi jetën shoqërore dhe kulturën shqiptare, ruajti identitetin kulturor dhe fisnor, dhe mbeti aktiv në shumë zona malore deri në shekullin XX.

3. Gjatë shekullit XIX, qytete shqiptare si Shkodra dhe Durrësi filluan të përjetojnë ndryshime ekonomike dhe sociale përmes shfaqjes së fabrikave të para dhe rritjes së tregtisë, duke organizuar prodhimin lokal dhe lidhur qytetet me tregjet osmane dhe ndërkombëtare. Ky zhvillim krijoi një shtresë të vogël punëtorësh urbanë dhe tregtarësh, ndikoi në urbanizim dhe infrastrukturë dhe ndryshoi gradualisht mënyrën e jetesës, ndërsa traditat rurale mbetën të forta. Megjithatë, krahasuar me qytetet industriale evropiane si Liverpool dhe Manchester, industrializimi në Shqipëri ishte i kufizuar dhe gradual, me ndikim më të vogël mbi urbanizimin, strukturën sociale dhe transformimin kulturor.
Analizoni ndikimin e industrializimit mbi shoqërinë shqiptare dhe krahasojeni atë me të një qyteti industrial evropian, si Liverpool ose Manchester, duke përdorur pikat e mëposhtme:

- a) Zhvillimi ekonomik **2 pikë**
Pyetje: Si ndryshoi ekonomia lokale pas shfaqjes së fabrikave dhe tregtisë?

Përgjigje e saktë:

Në qytetet shqiptare, industrializimi solli rritje të prodhimit dhe tregtisë lokale, me fabrika të vogla tekstili, ushqimore dhe druri për tregun rajonal.

Në Manchester dhe Liverpool, industrializimi ishte masiv, me prodhim për tregjet kombëtare dhe ndërkombëtare, duke krijuar një ekonomi shumë më konkurruese dhe të industrializuar.

- b) Ndikimi mbi strukturën sociale **2 pikë**
Pyetje: Si ndryshoi shoqëria pas industrializimit?

Përgjigje e saktë:

Në qytetet shqiptare, u formua një shtresë e vogël punëtorësh dhe tregtarësh urbanë, ndërsa pjesa më e madhe mbeti bujqësore.

Në Manchester dhe Liverpool, industrializimi krijoi klasë punëtore urbane të madhe, me migrim masiv nga zonat rurale dhe ndryshime të thella sociale.

- c) Ndikimi mbi jetën e përditshme dhe kushtet e punës **2 pikë**
Pyetje: Si ndryshoi jeta e njerëzve në qytet dhe cilat ishin kushtet e punës?

Përgjigje e saktë:

Në qytetet shqiptare punëtorët punonin me orë të gjata në kushte të thjeshta dhe me pak siguri

Në Manchester dhe Liverpool kushtet ishin shpesh të rënda dhe të rrezikshme, me ndotje, mungesë higjienë dhe organizim të nevojshëm për reforma sociale.

d) Urbanizimi dhe infrastruktura

2 pikë

Pyetje: Si ndikoi industrializimi mbi qytetin dhe infrastrukturën?

Përgjigje e saktë:

Në qytetet shqiptare, u përmirësuan rrugët, tregjet dhe magazinat, por urbanizimi mbeti i kufizuar dhe qytetet ishin të vogla.

Në Manchester dhe Liverpool, urbanizimi ishte shumë i shpejtë, me ndërtim fabrikash, banesa punëtorësh, rrugë dhe hekurudha që lidhnin qytetin me portet dhe tregjet industriale.

e) Krahësim i përgjithshëm

2 pikë

Pyetje: Cilat janë ngjashmëritë dhe dallimet kryesore mes qyteteve shqiptare dhe atyre industriale evropiane?

Përgjigje e saktë:

Ngjashmëri: të dy rastet tregojnë fillimin e zhvillimit industrial dhe ndikimin mbi tregtinë dhe punësimin.

Dallime: Qytetet shqiptare patën industrializim gradual dhe të kufizuar, me ndikim më të vogël mbi urbanizimin dhe strukturën shoqërore, ndërsa qytetet evropiane kishin industrializim masiv, urbanizim të shpejtë dhe ndryshime sociale dhe kulturore të thella.

4. Organizimi shtetëror i Shqipërisë ka kaluar nëpër periudha të ndryshme historike, nga fiset e decentralizuara të antikitetit, te principatat mesjetare, administrata osmane dhe deri te shteti modern pas pavarësisë. Çdo periudhë karakterizohet nga marrëdhënie të veçanta midis pushtetit qendror dhe autoritetit lokal, si dhe nga ndikimi i fqinjëve dhe Fuqive të Mëdha.

a) Analizoni organizimin shtetëror të Shqipërisë gjatë periudhës antike (Ilirët).

2 pikë

Përgjigje e saktë:

Gjatë periudhës antike, organizimi shtetëror ishte kryesisht i decentralizuar. Fiset dhe kryetarët lokalë kishin autonomi të konsiderueshme dhe merrnin vendime për luftë, aleanca dhe administrim të tokave. Qytetet dhe kështjellat vepronin si qendra të vogla me pushtet të kufizuar, ndërsa marrëdhëniet me fqinjët bazoheshin mbi aleanca të përkohshme ose konflikte për territor. Stabiliteti varej shumë nga fuqia dhe aftësia e liderëve lokalë.

b) Krahësoni organizimin shtetëror gjatë periudhës mesjetare me atë të antikitetit.

2 pikë

Përgjigje e saktë:

Në mesjetë, organizimi u bë më kompleks. Krijimi i principatave dhe mbretërive të vogla tregonte një përpjekje për centralizim të pushtetit, por princër të ndryshëm ruanin shumë autonomi mbi tokat e tyre. Marrëdhëniet me fqinjët, si Bizantin dhe shtetet ballkanike, ndikuan në strategjitë politike dhe aleancat. Ndryshe nga decentralizimi i fiseve të antikitetit, mesjeta solli një përqendrim më të madh të pushtetit, megjithëse i fragmentuar.

c) Analizoni organizimin shtetëror gjatë periudhës osmane dhe dallimet kryesore me mesjetën.

2 pikë

Përgjigje e saktë:

Gjatë sundimit osman, Shqipëria u integrua në një sistem administrativ më të centralizuar, ku pushteti qendror caktonte guvernatorë dhe kontrollonte taksat dhe drejtësinë. Megjithatë, bajraktarët dhe princër lokalë ruanin një autonomi të konsiderueshme, sidomos në zonat malore. Krahësuar me mesjetën, autoriteti qendror ishte më i fortë dhe kishte ndikim më të madh mbi vendimet administrative dhe mbrojtjen, por autonomia lokale mbeti një element kyç i stabilitetit.

- d) Analizoni organizimin shtetëror pas krijimit të shtetit të pavarur (1912) dhe krahasojeni me periudhat e mëparshme. **4 pikë**

Përgjigje e saktë:

Pas pavarësisë, Shqipëria filloi të ndërtonte një organizim shtetëror modern, me institucione qendrore të përgjegjshme për taksat, ushtrinë, drejtësinë dhe politikën e jashtme. Pushteti lokal strukturohej sipas rregullave shtetërore, duke zvogëluar autonominë e princërve apo bajraktarëve. Marrëdhëniet me fqinjët dhe fuqitë ndërkombëtare ishin vendimtare për ruajtjen e integritetit territorial dhe stabilitetin politik. Krahasuar me periudhat e mëparshme, pushteti qendror ishte më i fortë, më uniform dhe më i organizuar, duke e bërë shtetin modern më të aftë për të menaxhuar zhvillimin politik dhe ekonomik.

5. Pas Luftës së Dytë Botërore, Evropa u orientua drejt bashkëpunimit dhe integritetit, duke synuar tejkalimin e nacionalizmave agresive që kishin shkaktuar konflikte shkatërrimtare. Megjithatë, në dekadat e fundit, nacionalizmi është rishfaqur në forma të reja, duke ndikuar ndjeshëm në politikën evropiane dhe në diskutimet politike për vendet e vogla, përfshirë Shqipërinë.

- a) Analizoni transformimin e nacionalizmit evropian në periudhën bashkëkohore. **3 pikë**

Përgjigje e saktë:

Në periudhën bashkëkohore, nacionalizmi evropian ka pësuar një transformim të thellë krahasuar me formën e tij klasike të shek. XIX, kur synimi kryesor ishte ndërtimi i shteteve-komb dhe bashkimi territorial. Sot, nacionalizmi nuk ka më karakter shtet formues, por shfaqet kryesisht si nacionalizëm identitar, i përqendruar në mbrojtjen e identitetit kulturor, gjuhësor dhe historik të kombeve evropiane. Kjo formë e re e nacionalizmit lidhet ngushtë me shqetësimet për humbjen e sovranitetit kombëtar në një botë gjithnjë e më të globalizuar, ku proceset ekonomike, migratore dhe kulturore perceptohen nga një pjesë e shoqërive evropiane si kërcënim për identitetin tradicional.

Në këtë kontekst, nacionalizmi modern evropian shfaqet shpesh si reagim ndaj proceseve integruese të Bashkimit Evropian. Zgjerimi i kompetencave të institucioneve supranacionale (mbikombëtare) dhe transferimi i një pjese të sovranitetit nga shtetet anëtare drejt strukturave të përbashkëta kanë nxitur ndjenja euroskeptike dhe frikë nga dobësimi i rolit të shtetit-komb. Për pasojë, nacionalizmi bashkëkohor nuk kërkon më zgjerim territorial apo përplasje ushtarake, por synon kufizimin e ndikimit të mekanizmave supranacionalë dhe forcimin e autoritetit politik brenda kufijve kombëtarë ekzistues.

Një tjetër tipar i rëndësishëm i këtij nacionalizmi është lidhja e tij e ngushtë me populizmin politik. Në shumë vende evropiane, ai artikullohet përmes një diskursi që ndan shoqërinë në "popull" dhe "elita", si dhe në "ne" dhe "të tjerët", duke theksuar dallimet kulturore dhe identitare. Kjo retorikë nuk ka si objektiv ndryshimin e rendit ndërkombëtar përmes forcës, por mobilizimin elektoral dhe legjitimimin e pushtetit politik nëpërmjet apelimit ndaj ndjenjave kombëtare dhe frikës nga humbja e kontrollit mbi fatet e vendit.

Paradoksi kryesor i Evropës bashkëkohore qëndron në faktin se nacionalizmi dhe integrimi evropian bashkëjetojnë në të njëjtën hapësirë politike. Shtetet evropiane vazhdojnë të ekzistojnë si subjekte sovraane, me identitete të dallueshme kombëtare, por njëkohësisht janë të ndërlidhura ngushtë ekonomikisht, politikisht dhe institucionalisht. Kjo ndërvarësi e thellë nuk e ka zhdukur nacionalizmin, por e ka transformuar atë në një formë më të moderuar, e cila vepron brenda kornizës së paqes dhe bashkëpunimit ndërkombëtar.

Si përfundim, nacionalizmi evropian i sotëm mund të përkufizohet si defensiv, politik dhe identitar, larg formave agresive dhe ushtarake të së kaluarës. Ai pasqyron tensionin midis ruajtjes së identitetit kombëtar dhe nevojës për bashkëpunim supranacional, duke u shndërruar në një nga sfidat kryesore të Evropës bashkëkohore.

- b) Krahasoni mënyrën se si shfaqet nacionalizmi në diskutimet politike evropiane bashkëkohore me rolin që luan nacionalizmi në diskutimet politike shqiptare sot, duke evidentuar ngjashmëritë dhe dallimet kryesore. **3 pikë**

Përgjigje e saktë:

Nacionalizmi shqiptar ka një karakter historik të veçantë, i cili dallon dukshëm nga shumë forma të nacionalizmit evropian. Që në fillimet e tij në shek. XIX, ai u formësua si një nacionalizëm kryesisht çlirimtar dhe mbrojtës, i orientuar drejt ruajtjes së identitetit kombëtar dhe mbijetesës politike të shqiptarëve në një kontekst të pafavorshëm historik. Në mungesë të një shteti të pavarur, nacionalizmi shqiptar shërbeu si instrument unifikues, duke kapërcyer ndarjet krahinore dhe fetare dhe duke krijuar një ndjenjë përkatësie të përbashkët kombëtare.

Ky funksion unifikues ishte vendimtar për ndërtimin e vetëdijes kombëtare dhe për procesin e mëvonshëm të krijimit të shtetit shqiptar, duke i dhënë nacionalizmit një rol themelor në historinë politike të Shqipërisë.

Kjo trashëgimi historike vazhdon të ndikojë edhe sot në mënyrën se si nacionalizmi përdoret dhe perceptohet në diskutimet politike shqiptare. Në periudhën bashkëkohore, nacionalizmi shqiptar shfaqet kryesisht në formën e një retorike politike dhe simbolike, e cila synon të forcojë identitetin kombëtar dhe ndjenjën e unitetit shoqëror, më shumë sesa të promovojë projekte konkrete territoriale. Ai lidhet ngushtë me çështje që prekin identitetin kombëtar, marrëdhëniet rajonale dhe mbrojtjen e interesave kombëtare, duke reflektuar ndjeshmërinë historike të një kombi që ka kaluar periudha të gjata pasigurie politike dhe copëtimi territorial.

Ndryshe nga format radikale të nacionalizmit që hasen në disa vende evropiane, nacionalizmi shqiptar nuk synon ndryshimin e kufijve apo përplasje me fqinjët, por përqendrohet në afirmimin kulturor dhe në ruajtjen e unitetit kombëtar, si brenda kufijve të shtetit shqiptar, ashtu edhe në raport me shqiptarët që jetojnë jashtë tij. Kjo qasje e bën nacionalizmin shqiptar më tepër një faktor identitar dhe koheziv sesa përjashtues apo konfliktual.

Një element thelbësor që e karakterizon diskutimin bashkëkohor shqiptar është fakti se nacionalizmi nuk bie në kundërshtim me integrimin evropian. Përkundrazi, ai bashkëjeton me objektivin strategjik të anëtarësimit në BE, duke u paraqitur si plotësues i këtij procesi dhe jo si pengesë për të. Në këtë kuptim, nacionalizmi shqiptar synon të ruajë identitetin dhe interesat kombëtare, ndërkohë që Shqipëria kërkon të bëhet pjesë e strukturave evropiane, duke reflektuar një balancë mes përkatësisë kombëtare dhe integritit ndërkombëtar.

- c) Argumentoni nëse nacionalizmi në Evropën bashkëkohore vepron më shumë si faktor ndarës apo si faktor bashkues, duke mbështetur qëndrimin tuaj me shembuj historikë dhe aktualë. **4 pikë**

Përgjigje e saktë:

Nacionalizmi në Evropën bashkëkohore përfaqëson një fenomen kompleks, i cili mund të veprojë njëkohësisht si faktor ndarës dhe si faktor bashkues, në varësi të formës që merr dhe kontekstit politik në të cilin shfaqet.

Nga njëra anë, nacionalizmi bashkëkohor mund të veprojë si faktor ndarës. Në disa vende evropiane, ai shfaqet në forma përjashtuese, të lidhura me populizmin, euro-skepticizmin dhe kundërshtimin e migracionit. Ky lloj nacionalizmi thekson dallimet mes “neve” dhe “të tjerëve”, dobëson solidaritetin ndërmjet shteteve dhe vë në pikëpyetje parimet e bashkëpunimit evropian. Shembujt historikë tregojnë se kur nacionalizmi merr formë radikale, ai ka potencial destabilizues: përvojat e Evropës në gjysmën e parë të shekullit XX dëshmojnë se nacionalizmat agresive çuan në konflikte shkatërrimtare dhe ndarje të thella politike e shoqërore. Edhe sot, tensionet mes interesave kombëtare dhe institucioneve të përbashkëta evropiane tregojnë se nacionalizmi mund të dobësojë projektin integruar dhe të rrisë mosbesimin ndërmjet shteteve.

Nga ana tjetër, nacionalizmi mund të funksionojë edhe si faktor bashkues, veçanërisht kur shfaqet në forma të moderuara dhe përfshirëse. Në këtë kuptim, ai ndihmon në forcimin e kohezionit të brendshëm shoqëror, ruajtjen e identitetit kombëtar dhe legjitimitetin demokratik të shtetit. Brenda kornizës së Bashkimi Evropian, shumë shtete kanë arritur të ruajnë identitetin dhe traditat e tyre kombëtare, ndërkohë që bashkëpunojnë në fusha kyçe si ekonomia, siguria dhe politika e jashtme. Ky bashkëjetim tregon se nacionalizmi nuk është domosdoshmërisht në kundërshtim me integrimin, por mund të shërbejë si bazë për një Evropë të larmishme, të ndërtuar mbi respektin e identiteteve kombëtare.

Në këtë kontekst, dallimi thelbësor qëndron te forma e nacionalizmit. Nacionalizmi përjashtues dhe radikal tenton të jetë ndarës, pasi krijon barriera kulturore dhe politike, ndërsa nacionalizmi qytetar dhe demokratik mund të jetë bashkues, sepse forcon ndjenjën e përkatësisë pa mohuar bashkëpunimin ndërkombëtar.

Si përfundim, nacionalizmi në Evropën bashkëkohore nuk mund të cilësohet në mënyrë absolute as si faktor ndarës, as si faktor bashkues. Ai bëhet ndarës kur shndërrohet në mjet përjashtimi dhe përplasjeje, por mund të jetë bashkues kur shërben si instrument kohezioni, identiteti dhe dialogu brenda një Evrope pluraliste. Sfidat kryesore për shoqëritë evropiane sot është të menaxhojnë këtë fenomen në mënyrë demokratike, duke shmangur ekstremet dhe duke ndërtuar ura bashkëpunimi mes kombeve.